



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 05 mars 2021
Nr. ref.:RK 1722/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI163/20

Parashtrues

“Inter-Eminex”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës
së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës
për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
nr. AC-I-16-02560A001, të 21 majit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga kompania “Inter-Eminex”, të cilën e përfaqëson njëri nga pronarët e saj, përkatësisht, Izet Limani, me vendbanim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [nr. AC-I-16-02560A001] e 21 majit 2020 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) lidhur me Aktgjykimin [C-IV-16-0328] e 31 tetorit 2016 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 2 qershor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] e 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) e 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, ka kërkuar kthim në gjendje të mëparshme, sa i përket afatit për paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), në pajtim me nenin 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), duke theksuar se për “arsye shëndetësore” nuk ka pasur mundësi të dorëzojë kërkesën brenda afatit katër (4) muor, siç është përcaktuar në nenin 49 (Afatet) të Ligjit.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 47 (Kërkesa individuale) dhe 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës

7. Më 19 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë kërkesën për kthimin në gjendje të mëparshme, pasi kishte humbur afatin për të kontestuar Aktgjykimin [nr. AC-I-16-02560A001] e 21 majit 2020 të Kolegjit të Apelit lidhur me Aktgjykimin [C-IV-16-0328] e 31 tetorit 2016 të Kolegjit të Specializuar.
8. Më 23 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, duke përfshirë formularin e kërkesës.

9. Më 2 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
10. Më 17 nëntor 2020, Gjykata (i) e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar sqarim nëse kërkesën e kishte dorëzuar si individ apo në emër të kompanisë “Inter-Eminex”; dhe (ii) në bazë të nenit 21 (Përfaqësimi) të Ligjit dhe të rregullit 32 (2) (c) të Rregullores së punës, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që nëse kërkesën e tij e kishte dorëzuar në emër të kompanisë “Inter-Eminex”, të dorëzojë një autorizim për përfaqësim apo dëshmi mbi statusin e tij në kompaninë “Inter-Eminex”.
11. Më 1 dhjetor 2020, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dokumente shtesë, duke theksuar, ndër të tjerash, se është bashkëpronar i kompanisë “Inter-Eminex” dhe se kërkesën e tij e paraqet në emër të bashkëpronarëve të kompanisë. Në këtë kontekst, ai dorëzoi një autorizimit të vitit 2018.
12. Më 8 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
13. Më 15 dhjetor 2020, Gjykata pranoi nga DHPGJS fletëkthesën që dëshmon se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e kishte pranuar më 2 qershor 2020.
14. Më 11 janar 2021, Gjykata i'u drejtua edhe një herë parashtruesit të kërkesës me kërkesën që të sqarojë (i) nëse kërkesën e tij para Gjykatës e ka dorëzuar në cilësinë e tij si individ apo si cilësinë e tij si përfaqësues i kompanisë “Inter-Eminex”; dhe (ii) nëse kërkesa është paraqitur në emër të personit juridik, atëherë të dorëzojë para Gjykatës autorizimin për përfaqësim apo dëshminë lidhur me statusin përkatës në kompaninë “Inter-Eminex”.
15. Më 19 janar 2021, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës autorizimin e noterizuar bazuar në të cilin rezulton se (i) kompania “Inter-Eminex” ka katër bashkëpronarë, përkatësisht I.L., E.L., M.L., dhe Xh.L.; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës, është autorizuar nga E.L., M.L., dhe Xh.L., ndër të tjera, që t'i *“përfaqësoj pranë Gjykatës Kushtetuese [...] lidhur me lëndën me Nr.Kl163/20”*.
16. Më 18 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në DHPGJS kundër ndërmarrjes shoqërore “Urata”, ish ndërmarrja shoqërore “VOQAR” (në tekstin e mëtejme: N.Sh. “Urata”), duke kërkuar kompensim në emër të borxhit në vlerën prej 275,034.84 euro (në tekstin e mëtejme: shuma e kontestuar), me pretendimin se, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar mall në

N.Sh. "Urata", dhe për të njëjtin, nuk ishte kompensuar asnjëherë. Parashtruesi i kërkesës dhe N.Sh. "Urata", nuk kishin një kontratë të nënshkruar, por sipas pretendimit, përfaqësuesit e N.Sh. "Urata", kishin nënshkruar faturat e parashtruesit të kërkesës lidhur me mallin e dorëzuar.

18. Më 31 janar 2007, DHPGJS përmes Aktvendimit [SCC-06-0404] vendosi që lënda e parashtruesit të kërkesës t'i përcillet Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Qarkut) për vendimmarrje.
19. Më 24 prill 2007, Gjykata e Qarkut përmes Aktgjykimit [II.C.nr.79/2007], e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe detyroi N.Sh. "Urata" që parashtruesit të kërkesës t'i paguajë shumën e kontestuar me kamatë vjetore prej tre përqind (3%), nga 1 gushti 1999 dhe deri në pagesën definitive.
20. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, ankesë kishte paraqitur Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM). Megjithatë, pasi ndaj N.Sh. "Urata", ishte iniciuar procedura e likuidimit nga AKM, bazuar në shkresat e lëndës, procedura e lartcekur gjyqësore lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës ishte pezulluar.
21. Më 10 tetor 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në AKM, duke kërkuar që *"të keni parasysh shumën e borgjit e cila me Aktgjykimin e shkallës së parë [Gjykatës Ekonomike] iu është njohur paditësit, në bazë të faturave origjinale të prezantuara nga ana e [parashtruesit të kërkesës], dhe këtë shumë t'a ndani nga masa likuiduese, e për përmbushje të kërkesave të [parashtruesit të kërkesës]"*.
22. Më 23 qershor 2011, Autoriteti i Likuidimit i N.Sh. "Urata", përmes Vendimit [Nr.LPRN103-520], kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kompensimin e shumës së kontestuar, me arsyetimin se (i) kontrata bazuar në të cilën parashtruesi i kërkesës kërkonte pagesën e shumës së kontestuar, nuk ishte gjetur në arkiv; dhe (ii) nuk kishte dëshmi se malli në fjalë ishte pranuar nga N.Sh. "Urata".
23. Më 18 tetor 2011, kundër Vendimit të lartcekur të Autoritetit të Likuidimit, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në DHPGJS. Më 14 korrik 2014, Agjencioni Kosovar i Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), kishte paraqitur përgjigje në ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke propozuar që padia përkatëse të refuzohet si e pabazuar. AKP në mënyrë specifike kishte pretenduar se padia e parashtruesit të kërkesës është parashkruar bazuar në nenin 374 (Kërkesat reciproke nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore të vitit 1978 (në tekstin e mëtejme: LMD e vjetër).
24. Më 6 korrik 2015, Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit [SCL-11-0022], kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar Vendimin [Nr.LPRN103-520] e 23 qershorit 2011 të Autoritetit të Likuidimit.
25. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës, në esencë, theksoi se Kolegji i Specializuar gabimisht dhe në kundërshtim me provat,

kishte konstatuar se nuk kishte kontratë të vlefshme në mes palëve, duke venë theks në (i) faturat e “nënshkruara dhe të vulosura”, të cilat duhet të konsiderohen si dokumente të besueshme dhe për më tepër, mbi bazën e të cilave, bazuar në nenin 29 (Dokumentet e besueshme) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (në tekstin e mëtejme: LPP) të njëjtat kanë *“fuqi juridike sikurse vendimi gjyqësor i formës së prerë”*; (ii) faktin që bazuar në nenin 67 (Mosformaliteti i kontratës) të LMD-së së vjetër, jodetyrimisht një kontratë duhet të ketë formë të shkruar në mënyrë që të konsiderohet e vlefshme; dhe (iii) dëshminë e “*dyshimtë*” të Sh.S.-së dhe Xh.M.-së.

26. Më 26 maj 2016, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-15-0196-A0001], e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe lëndën e ktheu në rivendosje në Kolegjin e Specializuar, duke kërkuar, mes tjerash, që në procedurën e rishqyrtimit të dëgjohen edhe dëshmitarët Sh.S. dhe Xh.M.
27. Më 31 tetor 2016, Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit [C-IV-16-0328], e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin [Nr.LPRN103-520] të Autoritetit të Likuidimit. Lidhur me çështjen kontestuese që ndërlidhet me faturat e nënshkruara, si dhe nëse në rastin konkret ekziston një kontratë e vlefshme apo fiktive në mes të parashtruesit të kërkesës dhe N.Sh. “Urata”, Kolegji i Specializuar, ndër të tjera, arsyetoi se (i) bazuar në nenin 66 (Kontratë fiktive) të LMD-së së vjetër, kontrata në mes palëve, rezulton të ketë qenë fiktive dhe rrjedhimisht, e pavlefshme; (ii) faturat lidhur me mallin e dorëzuar ishin nënshkruar nga Drejtori Përgjithshëm i N.Sh. “Urata”, por se kjo *“nuk e përjashton mundësinë që në të vërtetë kontrata të jetë ekzekutuar me keqbesim [...] që njëra pala nuk do të kryente fare atë dhe përfaqësuesi i palës tjetër është plotësisht i vetëdijshme për këtë, por ai vepron në dëm të N.Sh.-së të cilën e përfaqëson”*; (iii) fakti që një kontratë e tillë nuk është bërë me shkrim dhe nuk është regjistruar në librat e N.Sh. “Urata”, dëshmon që Drejtori i Përgjithshëm i N.Sh. “Urata”, *“nuk ka pasur ndërmend që të lidh një transaksion tregtar normal, por planifikonte që të abuzonte me pozitën e menaxherit”*; (iv) faturat *“janë lëshuar në kundërshtim me të gjitha procedurat e brendshme në fuqi në N.SH-në e paditur dhe nuk ishin regjistruar në librat e saj”*; (v) nuk është ofruar asnjë dëshmi se malli i kontestuar është pranuar nga N.Sh. “Urata”; dhe (vi) dëshmitë e Sh.S.-së dhe Xh.M.-së, janë *“të besueshme dhe bindëse”*.
28. Më 21 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës, paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të lartcekur të Kolegjit të Specializuar, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu pretendoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Përmes kësaj ankese, ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës theksoi se (i) në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 9 (Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm) të Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për DHPGJS-në), seanca e shqyrtimit kryesor e mbajtur më 19 shtator 2016, është udhëhequr nga gjyqtari i vetëm, ndërsa Aktgjykimi përkatës është *“nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues”*; (ii) bazuar në nenet 66 dhe 67 të LMD-së së vjetër, arsyetimi i Kolegjit të Specializuar përkitazi me vlefshmërinë e kontratës është kontradiktor; (iii) dëshmitë e Sh.S.-së dhe Xh.M.-së nuk janë të besueshme; dhe gjithashtu propozoi (iv) të dëgjohen katër dëshmitarë të tjerë.

29. Më 21 maj 2020, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-16-02560A001], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C-IV-16-0328] e 21 majit 2020 të Kolegjit të Specializuar. Në refuzimin e ankesës përkatëse, Kolegji i Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 11 (Nën-kolegjet dhe Gjyqtarët e vetëm) të Shtojcës së Ligjit për DHPGJS-së dhe paragrafin 1 të nenit 9 (Mbajtja e procedurës nga nën-kolegji apo gjyqtari i vetëm) të Ligjit për DHPGJS-në, në seancë dëgjimore ishte prezent vetëm një gjyqtar, me kompetenca të deleguara nga Kolegji i Specializuar, ndërsa Aktgjykimi ishte nënshkruar nga Kolegji i gjyqtarëve, të cilët kishin vendosur në përbërje të plotë; (ii) Kolegji i Specializuar kishte bërë konstatim *“korrekt dhe ligjor”* lidhur me vlefshmërinë e kontratës dhe se në këtë rast nuk kishte *“krijim të normës juridike”*, siç pretendohet përmes ankesës së parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) përkitazi me besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarëve, theksoi se barra e provës bie mbi paditësin, përkatësisht parashtruesin e kërkesës, ndërsa ky i fundit, nuk kishte arritur të rrëzojë me asnjë argument e provë dëshmitë e tilla, e të cilat janë në pajtueshmëri të plotë me provat materiale të lëndës.

Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme

30. Parashtruesi i kërkesës fillimisht kërkon kthim në gjendje të mëparshme të afatit për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, siç është përcaktuar përmes nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit.
31. Parashtruesi i kërkesës arsyeton mos-dorëzimin e ankesës së tij kushtetuese brenda afateve të përcaktuara përmes nenit 49 të Ligjit, duke theksuar se *“për shkak të sëmundjes/infektimit me Covid -19 me simptoma shumë të rënda dhe me gjendje të rëndë shëndetësore rrezik për jetë, më është rekomanduar nga mjeku [...] pushim regjim shtrati 2 muaj dhe qëndrim në lartësi mbidetare të larta (Prevallë) për rehabilitim shëndetësor”*.
32. Ndërsa, kërkesën e tij për kthim në gjendje të mëparshme e arsyeton duke theksuar se (i) avokati i tij, ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 2 qershor 2020; (ii) më 10 tetor 2020, *“jam kthyer nga Prevalla dhe me shikimin e postës elektronike, jam njoftuar nga avokati”* lidhur me Aktgjykimin e kontestuar; ndërsa (iii) siç është përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, kërkesën e tij për kthim në gjendje të mëparshme e ka parashtruar më 19 tetor 2020, *“që nënkuptim brenda afatit 15 ditë që nga mënjanimi i pengesës, siç është shërimi nga sëmundja infektuese Covid 19 dhe leja ime për të lëvizur lirshëm në jetën private dhe publike pa frikë se mund t'a infektoj ndonjë person fizik me sëmundjen e Covid-19”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [nr. AC-I-16-02560A001] i 21 majit 2020 i Kolegjit të Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C-IV-16-0328] e 31 tetorit 2016 të Kolegjit të Specializuar, kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 21 [Parimet e përgjithshme] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

34. Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetues në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtuesi i kërkesës thekson se (i) procedura që ka rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit [C-IV-16-0328] të Kolegjit të Specializuar, *“është udhëhequr dhe drejtuar nga gjyqtari i vetëm pa praninë e gjyqtarëve tjerë të Kolegjit [...], kurse aktgjykimi është nënshkruar nga të gjithë gjyqtarët e Kolegjit [...] edhe nga gjyqtarët të cilët nuk kanë qenë prezentë në seancën kryesore”*, dhe rrjedhimisht, Aktgjykimi përkatës është nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 14 (Shfuqizimi i ligjeve të mëparshme; konfliktet; interpretimi) të Ligjit për DHPGJS-në, i cili përcakton se DHPGJS do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit nr.03/L-066 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), ndërsa pika a) e paragrafit 2 të nenit 182 [pa titull] të Ligjit për LPK-në, përcakton se shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore; (ii) në kundërshtim me nenin 67 të LPK-së, *“në të njëjtën çështje gjyqësore të marrë pjesë edhe gjyqtari i cili ka marrë pjesë në një trup gjykues tjetër të shkallës tjetër për të njëjtën çështje gjyqësore sepse në këtë shqyrtim ka marrë pjesë edhe gjyqtari i cili detyrimisht është dashur të vet përjashtohet”*, pa dhënë sqarime lidhur me gjyqtarin që ka marrë pjesë në dy shkallë të çështjes së tij gjyqësore; (iii) përkundër faktit që DHPGJS ka konstatuar se kontrata është fiktive, duke u bazuar në paragrafin 1 të nenit 66 të LMD-së sepse kontrata përkatëse do të duhej të ishte me shkrim dhe e protokolluar në librat e N.Sh “Urata”, paragrafi 1 i nenit 67 të të njëjtit ligj, përcakton se për qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve nuk është e domosdoshme lidhja e ndonjë kontratë formale; (iv) në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 339 [pa titull] dhe 349 [pa titull] të LPK-së, janë aprovuar dëshmitë e dëshmitarëve Sh.S., dhe Xh.M., përkundër faktit që asnjëri nuk kishte asnjë njohuri për mallin e kontestuar, sepse Sh.S. nuk ishte e punësuar në N.Sh. “Urata” gjatë vitit 1998-1999, ndërsa Xh.M., nuk ishte përgjegjës për pranimin e mallrave ushqimore; (v) katër dëshmitarët e propozuar nga ai nuk janë lejuar të deklarohen para gjykatës; dhe (vi) Aktgjykimet e kontestuarra janë kundërthënëse sepse në njërën anë konstatojnë se *“personi i cili i ka nënshkruar dhe vulosur faturat është person i panjohur dhe vula e panjohur”*, ndërsa në anën tjetër, theksojnë se *“nënshkrimin e bërë drejtori gjeneral i NSH'Urata' dhe se vula me te cilën janë vulosur është vula e NSH. Uratës”*.
35. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, përtej të referuarit në përmbajtjen e këtyre neneve, parashtuesi i kërkesës nuk ka arsyetuar dhe nuk ka paraqitur argumente përkitazi me shkeljen e tyre.
36. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) të aprovojë kërkesën e tij dhe të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme sipas nenit 50 të Ligjit; (ii) të shpallë kërkesën e tij të pranueshme; dhe (iii) të konstatojë se Aktgjykimi [AC-I-16-02560A001] i 21 majit 2016 i Kolegji të Apelit në lidhje me Aktgjykimin [C-IV-16-0328] e 31 tetorit 2016 të Kolegjit të Specializuar, është nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (iv) të anulojë të njëjtit, duke e kthyer çështjen e tij në rivendosje.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

39. Më tej, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

40. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”

41. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive

themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridik. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës nr. KI41/09, parashtrues, *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, parashtrues *"Bayerische Versicherungsverband"*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).

42. Më tej, Gjykata gjithashtu thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [nr. AC-I-16-02560A001] e 21 majit 2020 të Kolegjit të Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të vlerësojë nëse kërkesa është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh, siç është përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
43. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se përtej kriterit katër (4) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit për parashtrimin e kërkesave para Gjykatës sipas procedurës të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, përkatësisht kërkesave individuale, është gjithashtu pika (c) e paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe

[...]."

44. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [AC-I-16-02560A001] e 21 majit 2020 të Kolegjit të Apelit. Fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga DHPGJS, vërteton që parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 2 qershor 2020. Parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 19 tetor 2020. Rrjedhimisht, nuk është kontestuese se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej katër (4) muajsh të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
45. Megjithatë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata kthimin në gjendjen e mëparshme për sa i përket afatit për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë, siç është përcaktuar përmes nenit 50 të Ligjit.
46. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës arsyeton se kërkesën nuk e ka dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar përmes nenit 49 të Ligjit, (i) *"për shkak të sëmundjes/infektimit me Covid -19"*; (ii) se brenda kësaj kohe, ka qenë në *"regjim shtrati 2 muaj"* me rekomandim të mjekut përkatës; (iii) se nga avokati përkatës është njoftuar përkitazi me Aktgjykimin e kontestuar më 10 tetor 2020; ndërsa (iv) siç kërkohet në nenin 50 të Ligjit, kërkesën në Gjykatë e ka parashtruar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga mënjanimi i pengesës, përkatësisht më 19 tetor 2020.

47. Në kontekst të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për kthim të afatit në gjendje të mëparshme, Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit, i cili përcakton si në vijim:

“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.”

48. Bazuar në përmbajtjen e nenit 50 të Ligjit, në mënyrë që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme, duhet të plotëson kushtet në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht afatit katër (4) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit; (ii) parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës; (iii) parashtruesi i kërkesës duhet të arsyetojë kërkesën në fjalë; dhe (iv) nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me Ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Këto kushte janë kumulative.
49. Në rrethanat e rastit konkret dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata vëren se bazuar në fletëkthesën e dorëzuar në Gjykatë nga DHPGJS-së, parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit më 2 qershor 2020. Bazuar në nenin 49 të Ligjit, kërkesa në Gjykatë duhet të jetë dorëzuar deri më 2 tetor 2020. E njëjta është dorëzuar në Gjykatë më 19 tetor 2020. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me Ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë, dhe rrjedhimisht njëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 50 të Ligjit është plotësuar. Megjithatë, Gjykata, duhet gjithashtu të vlerësojë nëse janë plotësuar tri kushtet e tjera të përcaktuara përmes nenit 50 të Ligjit, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës (i) ka dëshmuar se pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar përmes nenit 49 të Ligjit; (ii) ka arsyetuar kërkesën e tij; dhe (iii) ka paraqitur kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga mënjanimi i pengesës.
50. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe një herë se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit më 2 qershor 2020. Raportet mjekësore të cilat janë të përfshira në shkresat e lëndës dhe të cilat i rekomandojnë parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, “qëndrim në lartësi mbidetare të larta (prevallë) 2 muaj”, mbajnë datat 4 dhe 8 gusht 2020, respektivisht. Në kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme të afatit, nuk ka asnjë arsyetim të vetëm lidhur me pamundësinë e dorëzimit të kërkesës përkatëse në Gjykatë nga momenti i pranimit të Aktgjykimit, përkatësisht 2 qershori 2020 dhe deri kur ka pranuar raportin e parë mjekësorë, përkatësisht 4 gushti 2020, rrjedhimisht për një periudhë kohor prej dy muajsh. Për më tepër, kërkesa në Gjykatë është dorëzuar në emër të një personi juridik, përkatësisht kompanisë “Inter-Eminex”, dhe i cili, bazuar në shkresat e lëndës, ka

edhe tre bashkëpronarë të tjerë. Në kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme të afatit, nuk ka asnjë arsyetim të vetëm lidhur me pamundësinë e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë nga bashkëpronarët e tjerë apo edhe të autorizuarit të tjerë të personit juridik përkatës, respektivisht avokati i cili kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit në emër të parashtruesit të kërkesës.

51. Gjykata rithekson se Gjykata ka detyrë të miratojë ose jo kthimin në gjendje të mëparshme të afatit, bazuar në vlerësimin e saj, në secilin rast veç e veç, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 50 të Ligjit dhe të cilat janë kumulative. Në rrethanat e rastit konkret, bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vlerëson se (i) parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht afatit katër (4) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit, sepse përderisa nuk është kontestuese që parashtruesi i kërkesës ka qenë i sëmurë me covid-19 që nga gushti 2020, në kërkesën e tij nuk ka asnjë arsyetim për pamundësinë e dorëzimit të kërkesës së tij në Gjykatë gjatë muajve qershor dhe korrik 2020 dhe për më tepër, asnjë arsyetim për pamundësinë e dorëzimit të kërkesës në Gjykatë nga ana e bashkëpronarëve të tjerë apo edhe të autorizuarve të tjerë të personit juridik; (ii) në po të njëjtin kontekst, parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon që pengesa është mënjeluar më 10 tetor 2020, datë kjo prej të cilës do të fillonte të rrjedhë afati pesëmbëdhjetë (15) ditore për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë, sepse nuk ka asnjë arsyetim lidhur me ekzistimin e ndonjë pengese për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë gjatë muajve qershor dhe korrik 2020; dhe (iii) për të njëjtat arsye, kërkesa në fjalë nuk është e arsyetuar.
52. Për pasojë, Gjykata vëren, se në rrethanat e rastit konkret, është plotësuar vetëm njëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 50 të Ligjit, përkatësisht afati një vjeçar brenda të cilit një kërkesë mund të paraqitet në Gjykatë duke kërkuar kthimin në gjendjen e mëparshme, dhe rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatojë që, në rrethanat e rastit konkret, nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuar përmes nenit 50 të Ligjit për kthim në gjendje të mëparshme, dhe të konstatojë se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
53. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Sabri Gunes kundër Turqisë*, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI107/20, parashtrues *Ismail Guri*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 dhjetorit 2020, paragrafi 41; KI140/13, parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; dhe KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).
54. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se (i) kërkesa nuk plotëson kushtet e përcaktuara përmes nenit 50 të Ligjit për kthim në gjendje të mëparshme; dhe për pasojë (ii) kërkesa është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse

përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të neneve 20, 49 dhe 50 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 18 shkurt 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për kthim në gjendje të mëparshme, për sa i përket afatit për paraqitje të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese;
- II. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajri

Arta Rama-Hajri